



Zyra e Shtypit  
16 prill 2007

**Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun e këmbimeve valutore në tremujorin e katërt të vitit 2006**

**1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË**

1.1. Operacionet e tregut të hapur

DATA	Tërheqje likuiditeti		Injektivim likuiditeti			Blerje me të drejta të plota e bonove të thesarit
	REPO njëjavë	REPO njëditë	R/REPO njëjavë	R/REPO njëmuaj	R/REPO tremuj	
02.10.2006						915.95
05.10.2006	2,625.00					
12.10.2006	1,910.00					
20.10.2006	500.00				1,000.00	
26.10.2006	1,500.00					
02.11.2006			0.00		2,000.00	
06.11.2006					1,000.00	
09.11.2006			0.00			
15.11.2006						800.00
16.11.2006			0.00			
23.11.2006			250.00			
30.11.2006			1,200.00			
07.12.2006			0.00		1,500.00	
14.12.2006			0.00	1,000.00	1,000.00	
21.12.2006			0.00			
28.12.2006			1,350.00			
29.12.2006		4,199				

**Tabelë 1:** Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

Teprica e likuiditetit që karakterizoi nëntë muajt e parë të vitit 2006, erdhi duke u pakësuar në tremujorin e fundit të vitit. Për të ruajtur nivelin e normave të interesit, Banka e Shqipërisë vazhdoi ndërhyrjet javore për tërheqjen e likuiditetit të tepërt. Por duke parashikuar mungesën e likuiditetit në muajt e ardhshëm, njëkohësisht vazhdoi injektimin e likuiditetit, sikundër në fund të tremujorit të tretë nëpërmjet instrumenteve të përkohshme (repo të anasjellta 3-mujore) dhe të përhershme (blerje me të drejta të plota e bonove të thesarit). Thellimi i mungesës së likuiditetit, solli në muajin nëntor ndryshimin e kahut të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë nëpërmjet instrumentit kryesor, duke filluar injektimin e likuiditetit edhe në bazë javore, krahas injektimit me instrumentet e përkohshme me afat më të gjatë.

Në mënyrë të përmbledhur, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2006, u injektuan rreth 7.50 miliardë lekë nëpërmjet instrumenteve të përkohshme me afat më të gjatë maturimi se një javë dhe rreth 1.7


miliardë lekë, nëpërmjet instrumentit me efekt të përhershëm – *blerjes me të drejta të plota të bonove të thesarit*. Ndërkohë që *instrumenti kryesor* u përdor për tërheqjen e likuiditetit në vlera mesatare rreth 1.6 miliardë lekë gjatë muajit tetor dhe rreth 0.93 miliardë lekë për injektimin e likuiditetit në tre raste të përdorimit të tij gjatë dy muajve të fundit të vitit.

## 1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të katërt, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i së cilës ishte 4,803 milionë lekë. Në kushtet e plotësisimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë tremujorit të katërt të vitit 2006, rreth 0.7 miliardë lekë në 2 raste përdorimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblodhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2006.

**Grafik 1:** Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2006.



## 2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor kanë vazhduar edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit të kaluar, duke synuar përmbushjen e objektivit të Rezervës Ndërkombëtare Neto, por edhe shmangien e çrregullimeve të tregut të brendshëm valutor. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë kanë qenë përsëri në kahun e

blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë. Këto blerje janë përqendruar në muajin dhjetor, që karakterizohet nga një ofertë e lartë valute.

Banka e Shqipërisë ka blerë gjatë tremujorit të katërt të vitit, 10.55 milionë usd me një kurs mesatar prej 93.50 lekë dhe 34.92 milionë euro me mesatarisht 123.45 lekë. Blerjet e Bankës së Shqipërisë gjatë gjithë vitit 2006, kanë qenë rreth 138 milionë usd në krahasim me rreth 126 milionë usd, në vitin 2005.

## 2.2 Veprime të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i Qeverisë Shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm, ku pagesat e kryera gjatë tremujorit të katërt llogariten në 2,144.58 milionë lekë.

Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave, për tremujorin e fundit të vitit, ka qenë 274.03 milionë lekë, ndërsa blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 127.55 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD). Tabela më poshtë jep në mënyrë të përmbledhur veprimet e kryera gjatë periudhës.

<b>Institucioni financiar</b>	<b>Blerje të valutës (në milionë lekë)</b>	<b>Shitje të valutës (në milionë lekë)</b>
BANKAT E NIVELIT TË DYTË	5,297.37	-
MINISTRIA E FINANCAVE	274.03	2,144.58
TË TJERA (IDA, IBRD)	127.55	-